Kronikë

Durrës/ Po trafikonte një automatik drejt Italisë, në pranga 66-vjeçari italian! Armën e kishte fshehur poshtë dyshekut në një rulot

Një rast i tentativës së trafikimit të armëve të zjarrit është goditur në pikën kufitare në Portin e Durrësit. Në pranga është vënë një shtetas italian, Giovanni Bedini, i cili po trafikonte një automatik drejt Italisë. Armën 66-vjeçari italian e kishte fshehur poshtë dyshekut në një rulot

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerilunta

Redaksia
22 Prill, 11:34 | **Përditësimi: 22 Prill, 11:45**

Share

DURRËS- Një rast i tentativës së trafikimit të armëve të zjarrit është goditur në pikën kufitare në Portin e Durrësit.

Në pranga është vënë një shtetas italian, Giovanni Bedini, i cili po trafikonte një automatik drejt Italisë. Armën 66-vjeçari italian e kishte fshehur poshtë dyshekut në një rulot.

> *'Shërbimet e Policisë Kufitare të portit të Durrësit, në vijim të kontrolleve në hyrje/dalje, të bazuara në analizën e riskut, me fokus parandalimin dhe goditjen e paligjshmërive kufitare, kanë goditur një rast të tentativës për trafikim të armëve të zjarrit, në dalje të RSh-së.'- njofton policia.*

[Sh.com]

LEXO EDHE:
'Çipuri', ish anëtari i bandës së Gaxhait në Vlorë vetëm pak ditë në qeli! Detajet si u lirua nga paraburgimi

Po ashtu është vënë në hetim edhe një 31-vjeçar, Ergit Haka për mosdeklarim të parave, në hyrje.

31-vjeçari nuk kishte deklaruar 16 300 euro dhe 100 paund.

> *'Shërbimet e Policisë Kufitare të portit të Durrësit, në vijim të kontrolleve në hyrje/dalje, të bazuara në analizën e riskut, me fokus parandalimin dhe goditjen e paligjshmërive kufitare, kanë goditur një rast të tentativës për trafikim të armëve të zjarrit, në dalje të RSh-së, dhe një rast të mosdeklarimit të parave, në hyrje.*
>
> *Për këto raste, veprimet hetimore dhe procedurale janë kryer nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës, të cilët kanë arrestuar në flagrancë shtetasin G. B., për veprën penale "Trafikimi i armëve dhe municionit", si dhe kanë referuar materialet në Prokurori ku ka nisur procedimi në gjendje të lirë për shtetasin E. H., për veprën penale "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë".*
>
> *Materialet procedurale i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.'- njoftoi policia.*



M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Durrës

Komento

Komente

Pjeter: 22/04/2024 13:02

Interesante te dihet ku e ka marre!! Me duket nje M16 qe kane ne perdorim forcat speciale shqiptare,apo te natos ne pergjithesi ne mos gabojne Shqiperi nuk eshte shume e perhapur ne krahasim me Kallashin.

Përgjigju

Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sa i përhapur është korrupsioni në Shqipëri?

Shumë | Pak | Nuk e di

Lajme të tjera

Pesë vite në pritje të rindërtimit, një grup banorësh në Durrës kërcënojnë me greve urie: S'kemi përgjigje për riforcimin e pallatit

Aldo Mustafa

23 Prill, 15:22

Durrës, Meta me delegatët e Konventës: Dëgjoj që lëir Meta është bërë diktator! E thonë ata që nuk marrin as 20 like

22 Prill, 20:01

Durrës/ Rrëmbeu nipin 3-vjeçar, lihet e lirë gjyshja Bahrije Gjuni: E bëra nga dashuria, pas vdekjes së djalit doja ta rrisja vetë nipin

22 Prill, 15:40

VIDEO/ Rrugëtim nëpërmjet teknologjisë në thesaret e Kullës Veneciane në Durrës

22 Prill, 10:04

VIDEO/ Mjegulla e dendur 'mbulon' aksin Thumanë-Vorë! Rinasi probleme me uljen e avionëve, shtyhen disa fluturime! Situata i kthehet normalitetit

22 Prill, 08:13

Durrës, u mbyt në det teksa peshkonte para 2 muajsh, gjendet në brigjet e Kroacisë trupi i Aurel Ndonit

20 Prill, 15:22

Durrës, i dënuar në Itali për trafik droge, arrestohet 59-vjeçari me qëllim ekstradimin (EMRI)

20 Prill, 14:38

Merr fund historia e rrëmbimit në Durrës, 3-vjeçari i dorëzohet nënës! Gjyshja vihet në pranga: Nipin donim që ta risnim vetë

Artur Korriku

20 Prill, 13:24

Nënën mund ta zëvendësojë edhe njëkonja, po shoqërinë nuk e zëvendëson dot kush

Çapajev Gjokutaj

20 Prill, 10:58

Rrëfimi i një gjyshi: Sa here shikoj nipin harroj që djali ka vdekur

Anila Hoxha

20 Prill, 07:01

Durrës/ Brenda vitit hapet parkimi me energji të vetëprodhuar nga dielli, 400 vende! Godina do ketë zyra e hapësira për evente

19 Prill, 13:14

7 ditë i zhdukur/ Vjojnë kërkimet për 3-vjeçarin, hetohet edhe largimi jashtë Shqipërisë! Gjyshi e kunati 'mbyllen' në qeli

19 Prill, 11:51

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësuar i kesaj faqeje